



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 626 Prot., i AK, datë 21.10.2022 “Depozitimi i Njoftimit për përqendrim në lidhje me fitimin e kontrollit tek Rosier SA nga Yilfert Benelux B.V., si rezultat i transaksionit të shit-blerjes së kuotave prej Borealis AG nga Yilfert Benelux B.V.”, nëpërmjet të cilës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Rosier SA dhe filialeve të saj nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e aksioneve në Rosier SA”, palët janë:

Blerësi: Yilfert Benelux B.V., është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, e cila operon si një shoqëri financiare holding. Yilfert Benelux B.V. është një SPV me qëllime të veçanta e krijuar për realizimin e këtij transaksioni, pjesë e Grupit Yildirim.

Grupi Yildirim është aktiv në Shqipëri në tregun minerar të prodhimit dhe furnizimit të ferrokromit dhe kromit, nëpërmjet filialit të tij Albchrome Holding SHPK.

Shitësi: Borealis AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me objekt aktiviteti ofrimi i zgjidhjeve inovative në fushat e poliolefinave dhe kimikateve bazë.

Grupi Borealis nuk ka prezencë ligjorike në Shqipëri por realizon të ardhura të kufizuara nëpërmjet shitjes së plehrave kimikë, kryesisht plehra kimike NPK (përmbajnë nitrat, fosfor dhe kalium), dhe një pjesë e vogël nëpërmjet shitjes së uresë.

Target: Rosier SA është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit belg, me objekt aktiviteti prodhimi i plehrave dhe komponimeve të azotit. Target nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri por ka realizuar të ardhura të kufizuara nga shitjet e plehrave kimikë NPK (të cilat përmbajnë Nitrat, fosfor dhe kalium). Për vitin 2022, Rosier SA nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në Shqipëri deri në datën e njoftimit të këtij transaksioni.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.